



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 357 Prot

Tiranë, më // /2 /2022

REKOMANDIM

Nr. 24, datë // /2 /2022

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK “PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË KRUJË”

Në mbështetje të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjë f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <https://www.pp.gov.al/Kruje/>, të Autoritetit Publik “Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Në nenin 5 të LDI parashikohet: “*Rishikimi i Programit të Transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.*”

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “*Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të*”

transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.

Në zbatim të gërmës “c”, pika 2 e nenit 4, nenit 5 dhe 6 të LDI, Zyra e Komisionerit ka miratuar Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar.

Autoritetet Publike të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhëri, zbatojnë Programin Institucional të Transparencës së Rishikuar, sipas formës dhe përmbajtjes, jo më vonë se data 30 qershor 2021.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të tij me informacion dhe dokumentacion publik.

Autoriteti Publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas Urdhrit nr.187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës pranë Zyrës së Komisionerit, kreu monitorimin on-line të faqes zyrtare të Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të rishikuar të transparencës.

Në lidhje me monitorimin e kryer, konstatohet se Autoriteti Publik, në menunë e faqes zyrtare ka të publikuar ikonën “Programi i Transparencës” ku në brendësi të së cilës janë vendosur fushat e programit të transparencës të ndara në ikona të veçanta, në përputhje me modelin e miratuar me Urdhrin nr.187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, i ndryshuar, të Komisionerit.

Në këto fusha është publikuar pjesërisht informacioni, mbi kuadrin ligjor rregullator, e drejta për t’u informuar, si dhe raportet për vitin 2020 tek rubrika informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun.

Në lidhje me monitorimin e kryer, Zyra e Komisionerit vlerëson mosvënien në zbatim të programit të transparencës së rishikuar, në përputhje me pikën 1 të nenit 7, të LDI, si dhe Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar të Komisionerit, konkretisht në rubrikat e mëposhtme:

a) Një përshkrim të shkurtër të strukturës organizative/organigramës, strukturës së pagave, funksioneve dhe detyrave të Autoritetit Publik;

b) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e monitorimit/ auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

c) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

d) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

dh) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë tarifat, formularët e aplikimit, afatin kohor, procedura e aplikimit;

e) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

f) sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

g) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji.

gj) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

h) në përputhje me pikën 3, të nenit 7, të LDI, dhe pikës 5, të nenit 46, të Ligjit nr.97/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", Autoriteti Publik rekomandohet të përfshijë në programin e transparencës gjithashtu vendime të rëndësishme të tij, udhëzime të përgjithshme të detyrueshme, si dhe çdo informacion që çmohet i dobishëm për qytetarët.

Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik duhet të publikojë informacionin e nevojshëm sipas Programit të Transparencës të Rishikuar miratuar me Urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, të ndryshuar, sipas gjetjeve të pasqyruara në lidhjen nr. 1 të këtij rekomandimi.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi Model i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës së autoriteteve publike dhe çdo autoritet është i detyruar ligjërisht t'a zbatojë atë.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, në zbatim të gërmave a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të publikojë, pasqyrojë, përditësojë, ndërlidhë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, të ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 1 të këtij rekomandimi.
2. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, “*Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me Komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre*”, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 45 ditë nga momenti i marrjes dijeni.
3. Në zbatim të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, pas përfundimit të afatit të mësipërm, Komisioneri do të nisë hetimin administrativ.
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 11.2.2022

KOMISIONERI
Besnik Dervishi



Lidhja nr.1

Raport i monitorimit për zbatimin e programit institucional të transparencës, bazuar në Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Autoritetin Publik/ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.**

Shkurt 2022

Ky raport monitorimi merr në konsideratë vetëm publikimin e informacioneve të cilat janë të ndërlidhura me programin e transparencës sipas Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”.

1	Rreth Autoritetit	
	Struktura organizative/Organigrama	Jo
	Struktura e pagave	Jo
	Funksionet dhe detyrat e AP	Jo
	CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre dhe procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime.	Jo
	Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e AP (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve	Jo
2	Kuadri ligjor rregullator	
	Legjislacion ndërkombëtar	Po
	Legjislacion kombëtar	Po
	Akte nënligjore	Po
	Rregullore	Po
	Kodi i sjelljes	Jo
	Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit	Jo
	Strategji	Po
	Raport vjetor	Po
	Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun	Jo
3	E drejta për tu informuar	
	Koordinatori / Emri mbiemri	Jo
	E-mail	Jo
	Nr. i gjelbër	Jo
	Tel:	Po
	Adresa:	Jo
	Orari:	Po
	Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)	Po

	Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)	Po
4	Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP	
	Rezolute Kuvendi	Jo
	Planet strategjike të punës	Jo
	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	Jo
	Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës	Jo
5	Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna financiare të autoritetit publik	
	Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (sipas viteve)	Jo
	Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve)	Jo
	Donacione, sponsorizime (sipas viteve)	Jo
	Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara	Jo
6	Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat	
	Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)	Jo
	Regjistri i realizimeve të prokurimit publik	Jo
	Informacion mbi monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme	Jo
	Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i përditësuar	Jo
7	Shërbimet që ofrohen nga AP	Jo
	Tarifat përkatëse	
	Formular aplikimi	Jo
	Afati kohor	Jo
	Procedura aplikimi	Jo
	Standartet për cilësinë e shërbimit	Jo
8	Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP	AP nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore.
	Njoftimi dhe konsultimi publik (Linku)	-
	Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi	-
	Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve	-
	Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes	-
	Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP	-
	Emër mbiemër koordinatori për konsultimin me publikun, adresë postare /elektronike	Jo

9	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve	
	Lista e dokumenteve që administrohen nga PP me afatet e ruajtjes	Jo
	Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)	Po
10	Rregjistri i kërkesave dhe Përgjigjeve	
	Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri)	Jo
	Kërkesat dhe përgjigjet (të linkuara për AP që nuk kanë instaluar portalin Pyet Shtetin/Portali Pyet Shtetin i përditësuar me kërkesat dhe përgjigjet)	Jo
11	Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP	AP nuk e ofron këtë shërbim
	Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP	-
	Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve	-
	Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim	-
	Procedura e ankimimit	-
12	Informacion/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun	
	Njoftime të ndryshme	Jo
	Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimimit në shërbim civil	Jo
	Raporte	Po
	Publikime	Po
	Statistika	Jo
	Projekte	Jo
	Bashkëpunime etj.	Jo